



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254838
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05619340

C.nr. 2508/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit "...", me adresë në "...", kundër të paditurit S.I, me adresë të banimit në "...", Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimin e dëmit material, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datë: 03.04.2024, mori dhe me datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses "...", me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri S.I, që në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të keqpërdorimit të energjisë elektrike, t'ia paguajë shumën prej 162,93 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja "...", me datë 26.09.2017, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurit me objekt kontesti kompensimin e dëmit. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, kundër të paditurit ka paraqitur kallëzim penal pranë prokurorisë themelore me arsyetimin se paditësi ka hequr dhe asgjësuar njehsorin elektrik numër 9443895 nëpërmjet të cilit është furnizuar me energji elektrike me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë elektrike apo asgjësimit të provave bindëse të keqpërdorimit të njehsorit. Ka theksuar se, bashkë me kallëzimin penal ka parashtruar edhe kërkesën pasurore juridike në lartësinë e dëmit të shkaktuar prej 162,93 euro. Tutje ka shtuar se, prokuroria publike kundër të paditurit, ka ushtruar propozim akuzën

PP.II.nr. "...” të datës 20.05.2013. Tutje ka shtuar se Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin P.nr. 1978/13 të datës 29.08.2017 e hedhë propozimin akuzues të ngritur ndaj të paditurit për shkak të parashkrimit relativ dhe paditësen për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në seancë të shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se, i padituri në mënyrë të pa autorizuar e ka keqpërdorë energjinë elektrike dhe i ka shkaktuar dëm paditëses. Ka theksuar se baza e kërkesëpadisë vërtetohet me kallëzimin penal dhe ngritjen e aktakuzës e cila për shkak të parashkrimit relativ është hedhur, por që një rrethanë e tillë nuk e liron të paditurin nga përgjegjësia për shkaktimin e dëmit dhe se kërkesa e paditëses nuk është e parashkruar, për faktin se, tek rastet penale çështja e parashkrimit është e rregulluar sipas dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri me përgjigje në padi ka theksuar se e kundërshton padinë e paditësit për shkak të bazës juridike, pasi që nuk është vërtetuar e njëjta, e po ashtu kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar, për arsye se dëmi ka ndodhur me datë 12.12.2012 ndërsa padia është paraqitur me datë 25.03.2017, ashtu që kanë kaluar më shumë se tri vite.

Në seancë gjyqësore i padituri ka deklaruar se nuk e ka keqpërdorur energjinë elektrike, dhe se punëtori i autorizuar i paditëses e ka vendosur orën e rrymës tre fazore, dhe e kanë tërhequr tre fazorin dhe e kanë vendosur orën digjitale, dhe se asnjë intervenim nuk është bërë.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi P.nr. 1978/13, datë 29.08.2017, Kallëzimi Penal 403, datë 01.03.2013, Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, nr. 0099926, shifra 35553, datë 12.12.2012, Fatura DPR13HP11973, datë 20.02.2013.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është në tërësi e pabazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të prova të administruara, gjegjësisht Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, nr. 0099926, shifra 35553, datë 12.12.2012, vërtetohet se zyrtarët e paditëses kanë konstatuar në vërtetimin në fjalë se, me kërkesë të vet paditëses të paditurit i ishte ndërruar njehsori, dhe se i padituri njehsorin e vjetër nuk e kishte prezantuar dhe i është bërë ndërrimi i

njehsorit, duke iu vendosur njehsori i “...”-ut, me numër të procesit 0099927. Nga provat e administruara po ashtu vërtetohet se paditësja pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kishte paraqitur kallëzimin penal me nr. 403, datë 01.03.2013, ndërsa nga Aktvendimi P.nr. 1978/13, datë 29.08.2017 vërtetohet se ndaj të paditurit ishte ngritur aktakuzë, e cila aktakuzë ishte hudhë me këtë aktvendim, për shkak të parashkrimit relativ të veprës penale. Ndërsa nga Fatura DPR13HP11973, datë 20.02.2013, vërtetohet se paditësja të paditurit i kishte faturuar të paditurit shumën prej 162,93 euro në emër të rikthimit të humbjeve, për dëmin e shkaktuar.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, kjo për faktin se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur që të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadiës, gjegjësisht nuk është arritur që të vërtetohet se i padituri duke e keqpërdorur energjinë eklektike, i ka shkaktuar dëm paditëses. Paditësja si prova ka paraqitur Vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, nr. 0099926, shifra 35553, datë 12.12.20122, sipas të cilit siç është theksuar më lartë vërtetohet se të paditurit i është ndërruar njehsori elektrik, dhe që paditësi nuk e ka prezantuar njehsorin e vjetër, megjithatë sipas këtij vërtetimi nuk vërtetohet asnjë nga faktet që paditësi të ketë keqpërdorur energjinë elektrike, e që rrjedhimisht ti ketë shkaktuar dëm material paditëses. Për më tepër paditësja si provë ka paraqitur edhe faturën DPR13HP11973, datë 20.02.2013, në të cilën është faturuar shuma e dëmit të shkaktuar, megjithatë sipas vlerësimit të gjykatës paditësja nuk ka arritur të vërtetoj faktin vendimtar, se i padituri i ka shkaktuar dëm material paditëses.

Po ashtu Gjykata vlerëson se në cilëndo situatë, kërkesëpadia e paditësit është po ashtu e parashkruar, kjo për faktin se nga koha kur pretendohet të jetë shkaktuar dëmi ndaj paditëses (datë:12.12.2012) e deri në kohën e paraqitjes së padiës (datë 27.03.2017) kanë kaluar më shumë se tre vite. Me nenin 357 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje referuar si: LMD) parashihet: *1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. 2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit.* Bazuar në paragrafin 1 të nenit 357 të LMD-së, rregullohet çështja e afatit subjektiv për parashkrimin e kërkesave për kompensimin e dëmit material. Sipas këtij paragrafi përcaktohen dy kushte për rrjedhjen e afatit subjektiv të parashkrimit. Së pari që i dëmtuar - paditësi të ketë marrë dijëni për dëmin e shkaktuar dhe së dyti të ketë marrë dijëni për personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Në këtë kuptim nga vet deklaratimet e palës paditëse në padi, rezulton se paditësi lidhur me dëmin është njoftuar me datë 12.12.2012, ndërsa po në të njëjtën datë është njoftuar edhe për personin

për të cilën pretendon se i ka shkaktuar dëmin. Kjo për faktin se zyrtarët e të paditëses me datë 12.12.2012 kanë përpiluar Vërtetimin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, nr. 0099926, shifra 35553, dhe në të njëjtin vërtetim është shënuar edhe emri i të paditurit, andaj rrjedhimisht paditësja ka qenë e njoftuar për dëmin dhe për shkaktarin që nga data 12.12.2012 ndërsa padia është paraqitur me datë 27.03.2017.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të paditëses se ndaj të paditurit është iniciuar procedurë penale, andaj edhe për parashkrimin e kërkesës zbatohet afati për parashkrimin e ndjekjes penale. Sa i përket këtyre pretendimeve, gjykata sjell në vëmendje dispozitën e nenit 358 të LMD-së, e cila rregullon si në vijim: *1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.* Referuar interpretimit të kësaj dispozite rezulton se dispozita në fjalë në fillim të saj rregullon situatën “*kur dëmi është shkaktuar me vepër penale (...)*”, pra kushti parësor është që dëmi të jetë shkaktuar me vepër penale. Ndërsa të vërtetuarit se dëmi është shkaktuar me vepër penale mund të bëhet vetëm me aktgjykim penal të formës së prerë, për shkak se përderisa nuk ka aktgjykim penal të formës së prerë me të cilin i padituri është shpallur fajtor, nuk mund të konkludohet se dëmi është shkaktuar me vepër penale. Referuar rrethanave të rastit konkret, ndonëse ndaj të paditurit është ngritur aktakuzë, me Aktvendimin P.nr. 1978/13, datë 29.08.2017, është hudhë aktakuza për shkak të parashkrimit relativ të veprës penale, pra rasti penal ndaj të paditurit nuk ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë me të cilin i padituri është shpallur fajtor. Rrjedhimisht, bazuar në këto fakte, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk mund të zbatohet afati i paraparë për parashkrimin e veprës penale.

Nga të gjitha arsyetimet si më lartë, Gjykata vlerëson se paditësja ka dështuar që në procedurë gjyqësore të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë, ngase nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të vërtetohej se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses. Gjykata sjell në vëmendje se pala që pretendon kompensim e dëmit ka për obligim që në procedurë gjyqësore të vërtetoj faktin se të njëjtës i është shkaktuar dëm, vëllimin e dëmit, shkaktarin e dëmit, dhe kuazalitetin mes veprimit të dëmtuesit dhe dëmit të shkaktuar. Me nenin 319 të Ligji për Procedurën Kontestimore, parashihet si në vijim, *319.1 Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.* Sipas kësaj dispozite ligjore, përcaktohet se pala që pretendon një fakt, ka për obligim provimin e fakteve mbi të cilat i bazon pretendimet e veta, dhe rrjedhimisht bartë konsekuencat mos vërtetimit të fakteve në procedurë gjyqësore.

Vendimin nga pika II e dispozitivit të aktgjykimit, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, e cila përcakton: *Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2508/2017, datë 25.04.2024

Gjyqtari

Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.